



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1574/1 Prot

Tiranë, më 07.11.2019

V E N D I M

Nr.121, datë 07.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Peqin të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Peqin,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.09.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Peqin.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka

rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Peqin, me Vendimin nr. 83, datë 22.12.2018, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Peqin dhe njësisve administrative e institucioneve në varësi të saj. Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Peqin, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ka nxjerrë Urdhrin nr. 13, datë 05.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Peqin për vitin 2019”. Kjo strukturë dhe organikë është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Peqin së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **47** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **6** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese; **6** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **35** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Për sa më sipër, u evidentua se, në strukturën aktuale të Bashkisë Peqin, mungon kategoria “*niveli i lartë drejtues*”. Ky fakt krijon vështirësi në zbatimin e disa skemave të administrimit të shërbimit civil siç janë: ngritja e komisioneve disiplinore; miratimi i përshkrimeve të punës; sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë; ngritjen e Komiteteve të Pranimit gjatë procesit të rekrutimit. Për të siguruar zbatimin e parimeve të administrimit në shërbimin civil, Bashkia Peqin, duhet ta përshtasë strukturën me skemën e shërbimit civil dhe në zbatim të parimit të hierarkisë administrative, duhet të parashikojë në strukturë pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, i cili i përgjigjet kategorisë së lartë drejtuese.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **23** pozicione pune të shërbimit civil janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **24** pozicione të shërbimit civil, rezulton se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; në momentin e verifikimit nuk rezultoi asnjë vend vakant në shërbimin civil.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. ***** , Përgjegjës i Aplikimit të Projekteve, emëruar me aktin nr. 08 prot., datë 08.01.2018;
2. ***** , Specialist për Projektet, emëruar me aktin nr. 20 prot., datë 19.02.2019;
3. ***** , Specialist për Informimin e Publikut, emëruar me aktin nr. 02 prot., datë 08.01.2019;

4. *****, Specialiste e Auditit të Brendshëm, emëruar me aktin nr. 372 prot., datë 01.02.2019;
5. *****, Specialist i Auditit të Brendshëm, emëruar me aktin nr. 144 prot., datë 02.08.2018;
6. *****, Specialist Jurist, emëruar me aktin nr. 1054 prot., datë 02.05.2019;
7. *****, Administatore e Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Shezë, emëruar me aktin nr. 189 prot., datë 11.12.2018;
8. *****, Psikolog, emëruar me aktin nr. 30 prot., datë 19.02.2018;
9. *****, Specialiste e Taksave dhe Tarifave Vendore, emëruar me aktin nr. 09, prot., datë 16.01.2018;
10. *****, Specialist Apeli Tatimor, emëruar me aktin nr. 1478 datë 26.06.2019;
11. *****, Kordinatore lokale e B.E-së, emëruar me aktin nr. 6 prot., datë 04.01.2019;
12. *****, Drejtor i DPZHKT, emëruar me aktin nr. 162 datë 01.10.2018;
13. *****, Specialiste Inxhiniere Mjedisi, emëruar me aktin nr. 05 datë 04.01.2019;
14. *****, Specialist Inxhinier Gjeodet, emëruar me urdhrin nr. 10, datë 24.2.2016;
15. *****, Jurist, emëruar me aktin nr. 1819 prot., date 19.08.2019;
16. *****, Administatore e Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Karinë, emëruar me urdhrin nr. 43, datë 31.8.2015;
17. *****, Administator i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Gjocaj, emëruar me urdhrin nr. 123, datë 6.06.2017;
18. *****, Administator i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Pajovë, emëruar me urdhrin nr. 76, datë 21.10.2015;
19. *****, Administator i Ndhmës Ekonomike, Njësia Administrative Përparim, emëruar me urdhrin nr. 72, datë 30.9.2015;
20. *****, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe TIK, emëruar me aktin nr. 1764 prot., datë 13.08.2019;
21. *****, Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësia Administrative Përparim, emëruar me urdhrin nr. 47, datë 15.2.2016;
22. *****, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve, emëruar me aktin nr. 1818 prot., datë 19.08.2019.

➤ Punonjës ekzistues të cilët janë të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, por nuk i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të vendit të punës.

23. *****, Specialiste Buxheti, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, emëruar me urdhrin nr. 67, datë 01.10.2008;
24. *****, Specialist i Kadastrës Urbane, në Drejtorinë e Planifikimit Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 55, datë 15.10.2008.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë, ashtu edhe të njërive administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Peqin, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të

vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Nga verifikimi i listë prezencës dhe listë pagesës së muajve korrik-gusht 2019, u konstatua largimi nga detyra i dy nëpunësve si më poshtë:

- ***** “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, larguar nga detyra me Urdhrin nr. 83, datë 02.07.2019, “*Pezullim i statusit të nëpunësit civil dhe largim nga puna*”.

Nga analiza bërë akteve në dosjen personale të tij, rezulton se, ky veprim është kryer në kundërshtim me procedurat ligjore. Konstatohet se, situata e ligjshmërisë është rivendosur nga vetë institucioni, duke rikthyer nëpunësin H.Meta në pozicionin e mëparshëm, nëpërmjet aktit nr. 1828 prot., datë 20.08.2019, “*Për lidhjen e marrdhënieve financiare*”.

- ***** “*Drejtor i Shërbimeve Bujqësore*”, larguar nga detyra me Urdhrin nr. 82, datë 02.07.2019, “*Pezullim i statusit të nëpunësit civil dhe largim nga puna*”;

Për sa i përket rastit të nëpunësit Z.Dedej, duke analizuar përmbajtjen e urdhrin për largimin nga shërbimi civil, rezulton se, motivacioni ishte kërkesa e tij për të ndërprerë marrëdhënien e punës, por akti i dorëheqjes së tij nuk ndodhej në dosjen personale. Gjatë kohës së verifikimit në subjekt, nëpunësi në fjalë, parashitroi pretendimet në lidhje me largimin e padrejtë të tij nga detyra. Pas kësaj nëpunësi depozitoi një kërkesë me objekt “*Kërkesë për rikthim në detyrën e Drejtorit të Shërbimeve Bujqësore, Veterinare e Pyjeve, pranë Bashkisë Peqin*”, protokolluar pranë institucionit të inspektuar me nr. 2285 prot., datë 26.09.2019, një kopje e të cilës u administrua nga Komisioneri në dosjen e inspektimit.

Aktet e largimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo përfundim të marrdhënies në shërbimin duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt largimi ose lirimi nga shërbimi civil, duke marrë parasysh përcaktimet në nenet 63, 64, 65, 66, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. *Çdo largim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Në rastin konkret nuk ndodhemi në asnjë nga kushtet e parashikuara për largimin apo lirimimin nga shërbimi civil. Gjatë verifikimit, nuk rezultoi asnjë akt që të materializojë një procedurë disiplinore, e po kështu nuk u evidentua asnjë rrethanë që të plotësonte kushtet për të konstatuar ekzistencën e elementëve të lirit nga shërbimi civil të parashikuara nga nenit 65, 66, të ligjit për shërbimin civil.

Sa më sipër, ndodhemi në kushtet e nenit 108 dhe 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, të një veprimi administrativ absolutisht të pavlefshëm, i cili nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Peqin, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 82, datë 02.07.2019, “Pezullim i statusit të nëpunësit civil dhe largim nga puna”, dhe të rregullojë pasojat, duke rikthyer në detyrë nëpunësin
*****.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Peqin, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **24** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi dhe të rregullojë pasojat duke i shpallur të lira këto pozicione, me qëllim që të plotësohen në përputhje me ligjin.
2. Kryetari i Bashkisë Peqin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 82, datë 02.07.2019, “Pezullim i statusit të nëpunësit civil dhe largim nga puna” dhe të rregullojë pasojat duke rikthyer në detyrë nëpunësin *****.
3. Njësia përgjegjëse të vijojë realizimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet e lira, duke aplikuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit.
4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108,

datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

5. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 74, datë 31.07.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Peqin dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë” të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Peqin, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Peqin, Ministria e Brendshme dhe Prefektura e Qarkut Elbasan. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Peqin duhet të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim për detyrat e lëna në dispozitivin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha